

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Lehtësia e papërballueshme e të mos marrit seriozisht asgjë
ADRESA	https://www.gazetatema.net/blogu-tema/lehtesia-e-paperballueshme-e-te-mos-marrit-seriozi-sht-asgje-i588297
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	edited

KOHË


KAPUR NGA NE	25 shtator 2026, 10:36:12 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	25 shtator 2026, 10:33:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	6a4aaadcaa34c2ee3b5d64c61740a7836567c461751b0eeb437d0f31c458a7a1
TEKSTI	0199fff6c6099690c677a944a02a275acdd049a5a79d7aed97687a965b9cbd3e
PAMJA	0e09160391524f0106658eaa2bf814d2b13f652d4bd2927106176484b4609a89

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	14ddd8ce49fbfcbdccda5fb5be58ccbbbe5145f2ca3e77b3438675b19d38ee93
E MËPARSHMJA	6ce883eaa262638d029c36b70c07090d5666a8529cf332d887a34c826701d5e6
RRËNJA MERKLE	9f67fd8f5341aacd98433415ae2bd1fabd75d8584ec60b7ea3d19ca47caca387
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/14ddd8ce49fbfcbdccda5fb5be58ccbbbe5145f2ca3e77b3438675b19d38ee93>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

 English

Built and Monetized by  [Kontakt](#)

 English

1 e [Mali i Zi vendos viza per shtetasit nga Rusia, Bjellorusia dhe Turqia](#) [DPA paraqiti nje ekspozite me dokumente mbi historikun e marrredhenieje Shqiperi-Kine](#) [VIDEO/ Net-fundit](#)

Lehtësia e papërballueshme e të mos marrit seriozisht asgjë



25 Shtator 2026, 12:33Blog Bjorn Runa

Teksa shihje seancën e djeshme plenare, ishte e vështirë të përcaktoje nëse ajo që e bënte më depresive ishin akuzat e shkëmbyera, apo lehtësia e papërballueshme me të cilën një pjesë e deputetëve zgjodhën t'i injoronin ato. Edhe pse nga ajo sallë jemi mësuar tashmë të mos presim ndonjë gjë brilante veç spektakleve të herë pas hershme, ishte megjithatë e trishtë të shihje se si mes debatit në lidhje me ish kreun e SHISH, një pjesë e mirë e përfaqësuesve tanë në parlament kishin kohën dhe qetësinë mendore të bënin scroll nëpër rrjete sociale dhe të blinin online, se tek e fundit stinët po ndërrohen dhe duhet përditësuar garderoba. Me sa duket, çështja në diskutim ishte mjaftueshëm serioze për t'i bërë titur njëri tjetrit nga foltorja, por jo aq sa duhet për t'i kushtuar vëmendje.

Akuzat ndaj ish kreut të SHISH Vlorë Hyseni, përfshijnë dhënien e informacioneve sensitive tek një person në kërkim, me gjasë për ta ndihmuar t'i shpëtojë arrestit. Ndonëse mbeten për t'u provuar në gjykatë, sërish edhe në këtë fazë, pritët që parlamenti të tregojë njëfarë interesi të paktën në lidhje me mënyrën si është mbikëqyrur institucioni i drejtuar deri pak më herët nga Znj. Hyseni dhe çfarë masash ekzistojnë për të shmangur ngjarje të tilla.

Por, siç u pa, përgjigjia e mazhorancës ishte gati dhe mjaftonte të zgjaste dorën në të shkuarën e opozitës zyrtare. Përballë pyetjeve dhe dilemave që qytetarët kanë në lidhje me atë çfarë ka ndodhur, mazhoranca e gjeti komfortin tek diskutimi i atyre që kundërshtarët e saj kanë bërë kur kanë qenë në pushtet, duke pranuar disi heshturazi (pavarësisht toneve të larta, e gjitha mbetet heshtje), se sa të panevojshme e ndien që të japësh shpjegime, gjë që pala përballë ja bën edhe më të lehtë. Opozita nga ana tjetër shfaq një qëndrim edhe më pak të dobishëm për publikun. Edhe pse kishte në duar një skandal mjaftueshëm serioz për të kërkuar llogari në mënyrë precise, zgjodhi t'i shpenzonte energjitë e saj në një mënyrë të njohur tashmë për të gjithë, duke u përqëndruar tek një shqetësim performativ dhe etiketim të vjetëruara, që shumicës së njerëzve nga një vesh ju hyjnë e nga tjetri ju dalin, sepse në vetvete nuk thonë asgjë. Nëse çdo ngjarje s'është veçse provë e akuzave të vjetra që shkëmbehen prej më shumë se tridhjetë vjetësh, atëherë nuk ka përse të përcaktohet se si mund të ketë ndodhur ky dështim konkret.

Kush ishte përgjegjës për të mbikëqyrur kreun e SHISH? Çfarë kontrollesh ekzistojnë në lidhje me informacionet që i lejohet t'i ndajë dhe atyre që mbeten sekret? A ka patur më parë shqetësim në lidhje me kontaktet e saj dhe nëse po, atëherë kush mund t'i binte ziles së alarmit dhe në ç'zyrë? Janë të gjitha pyetje të zakonshme, por përgjigjet e të cilave mund të identifikojnë dështime përtej personit tanimë nën hetim.

Por marrëdhënia intime e raportuar duket se garanton një temë diskutimi shumë më të lehtë për të gjithë, duke e shndërruar një thyerje të mundshme të sigurisë së shtetit, në një debat për sjelljet private të drejtueses së institucionit në fjalë. Duke u përqëndruar te kjo anë, do të ketë mjaftueshëm gjëra për të insinuuar dhe plot hollësi që disave iu ngrënë humoret dhe të tjerëve iu ulin radarin, duke rrezikuar që jetës personale të Znj. Hyseni t'i bëhet hetimi që do duhej t'i bëhej institucionit të drejtuar prej saj.

Po pavarësisht gjithë këtyre, ajo që të ngelet në mendje është imazhi i deputetëve krejt shpërfillës gjatë seancës plenare të së enjtes. Ankesat se është shkelur kodi i sjelljes së parlamentit nuk është se thonë shumë, pasi në atë sallë kemi parë sjellje nga më banaanet, tek ato më të rrezikshmet për sigurinë fizike të vetë deputetëve, por edhe punonjësve të administratës. Ajo që flet më shumë është mërzia e tyre e dukshme gjatë seancës sepse ishte pamja e njerëzve që e kanë të qartë se pozicioni i tyre nuk varet nga fakti nëse dëgjojnë ose jo atë që thuhet. Opozita mund të përfundonte akuzat e përhershme, mazhoranca do të prodhonte votat e nevojshme për atë seancë dhe askujt nuk do t'i duhej të dinte diçka më shumë nga sa dinin në nisje të saj.

Vendi pati për disa orë arsye të shqetësohej nëse sekretet e tij ishin të sigurta, por në Kuvend shumëkush dukej i qetë se të paktën karrigen e kishte të sigurt.

2 Komente



Dire Straits !!!!

25 Shtator 2026, 12:47

.....bojaxhiu duhet te merrte masa qe SHISH te paisej me "terapistë seksi" , te cilet do te ndihmonin Vloren qe te perballonte frustrimin seksual dhe te mos nxirrte sekretet e shtetit ner 5 minuta elirim hormonal . ne fund te fundit , neveria mund ti kishte siguruar Vlores nie "vibrator" dhe

keshtu "radari i Gysit" nuk kishte pse te fikej.....sepse "ia fikte" vibratori llambat "Vlores se perveluar".....!!!!

↩️ **Përgjigjuni**

👍 0 🗳️ 0 ❤️ 0

K

Kjo është bër me dashje nga Rama dhe Saliu

25 Shtator 2026, 12:50

Edi Rama dhe Sali Berisha, janë kancer për Shqiprinë.... Prandaj e kanë mbushur palamentin dhe të gjitha instutusjonet e " shteti" nës mund ta qusha shtet? me kriminel, hajdut, analfabetik dhe budallen, që askush të mosë shpëtoj nga kjo llumhanjë që keta kanë ndertue.. SPAK na shpeto nga këta kriminel...

↩️ **Përgjigjuni**

👍 0 🗳️ 0 ❤️ 0

💬 Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[Këshilli i Sigurisë së Kombit që mbledhet për "radarin" e Gysit](#)

11:28 Blog / 17 komente

[Foreign Policy Journal: Reforma në drejtësi e Shqipërisë ka krijuar një pushtet pa llogaridhënie](#)

10:00 Blog / 11 komente

[Shërbimi ynë jo inteligjent](#)

22:49 Blog / 22 komente



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.